VENDIM
Nr.633, datë 23.5.2008

PËR FUNKSIONIMIN, TË DREJTAT DHE DETYRAT E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË TITUJVE AKADEMIKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 67 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë (KVTA) funksionon si organ kolegjial, vendimmarrës, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

2. Ky komision, në ushtrim të funksioneve dhe të përgjegjësive, të përcaktuara në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kryen dhe ka këto detyra e të drejta:

a) Vlerëson dhe merr vendim për propozimet e institucioneve të arsimit të lartë, për dhënien e titullit akademik "Profesor". Propozimet dhe vendimet për dhënien e titullit regjistrohen nga sekretariati i KVTA-së, në regjistrin e krijuar për këtë qëllim.

Formati i regjistrimit të të dhënave përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

b) Kryen njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë të gradave ose titujve shkencorë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë, sipas procedurave, të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Kërkesat dhe vendimet për njohjen e titullit regjistrohen nga sekretariati i KVTA-së, në regjistrin e krijuar për këtë qëllim. Formati i regjistrimit të të dhënave përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

c) U bën rekomandime institucioneve të arsimit të lartë për organizimin e studimeve të doktoratës dhe promovimin për titujt akademikë.

ç) Vlerëson, me kërkesë të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, zbatimin e kritereve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor nga institucionet e arsimit të lartë dhe, kur vëren shkelje të kuadrit ligjor dhe nënligjor, propozon masat përkatëse.

d) Gëzon të drejtën të dërgojë përfaqësuesit e vet, për të mbikëqyrur procedurat për mbrojtjen e doktoratave, si dhe për shqyrtimin e titujve akademikë, të cilat zhvillohen nga institucionet e arsimit të lartë në mbledhjet (seancat) e hapura.

KVTA-së mund t'i ngarkohen edhe detyra të tjera për kualifikimin shkencor, në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. KVTA-ja merr vendim me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

4. Komisioni mblidhet me njoftim të kryetarit, sipas rendit të ditës, të përcaktuar prej tij.

5. Mbledhjet zhvillohen sipas rregullores, të miratuar nga vetë KVTA-ja.

6. Përbërja e Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë përcaktohet në përputhje me vendimin nr.599, datë 31.8.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e komisionit të kualifikimit shkencor".

7. Pagesa e kryetarit dhe e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë, për çdo muaj, nëse zhvillohen mbledhje, të jetë, përkatësisht, 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj kryetari, dhe nga 13 000 (trembëdhjetë mijë) lekë në muaj anëtarët. Kryetari dhe anëtarët e këtij komisioni nuk e përfitojnë këtë shpërblim për muajt që nuk mblidhen.

8. Efektet financiare, prej 2 364 000 (dy milionë e treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekësh, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha